V E N D I M
Nr. 185, datë 3.5.2002

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 397, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË GRAVE SHTATZËNA DHE TË AMËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 100 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 397, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e vecantë të grave shtatzëna dhe të amësisë" të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 4, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji ndalohen të ngrenë pesha mbi 5 kg.".

2. Në pikën 5 paragrafi i tretë, pas fjalëve "… herë pas here gjatë ditës…" shtohen fjalët "… të paguara, jo më pak se 20 minuta për çdo tri orë pune të vazhdueshme …".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko